



FEDERATA SHQIPTARE E MOTOÇIKLIZMIT

"MotoRally 2026"

RREGULLORE E PËRGJITHSHME E KAMPIONATIT .

Cilësime

- i- Federata Shqiptare e Motoçiklizmit organizon Kampionation Kombëtar "MotoRally 2026".
- ii- Kampionati në **Edicionin 2026** do të përbëhet nga gjashtë gara.
- iii- Çdo garë ka sistem pikësh.
Piloti **Kampion Kombëtar "Motorally 2026"** do të shpallet nga shuma e pikëve të marrë në garat që ka marrë pjesë.

1. Të përgjithshme

Gara, e cilësuar si i tillë që organizohet në një ditë, përfshin të gjitha provart speciale dhe ato lidhëse.

Gara, fillon në momentin e përcaktuar në axhendën e eventit dhe përfundon 30 minuta pasi juria shpall rezultatin zyrtar.

2. Klaset

- 2.1 Të gjitha klaset pjesëmarrëve do të jenë brenda rregullores së Federatës.

3. Pilotët

- 3.1 Të gjitha garat e Kampionatit janë të rezervuara vetëm për mbajtësit e një Licence Kombëtare Shqiptare gare të vlefshme për vitin 2026 në disiplinën "MotoRally".
- 3.2 Mosha minimale e lejuar e pilotëve pjesëmarrës është 18 vjeç
- 3.3 Patenta rrugore standard e klasit A, është e detyrueshme për këtë disiplinë.

4. Motori

- 4.1 Çdo tip motori që përfshihet në Klasët e paracaktuara, mund të marrë pjesë në garë.

Klasi M-1	(Moto, monocilindër deri 599 cc)
Klasi M-2	(Moto, monocilindër mbi 599 cc)
Klasi M-3	(Moto, bicilindër)
Klasi M-4	(Moto, veteran, lindur para 1 janarit 1972)
Klasi M-5	(Moto, garuese femër)
Klasi Q-1	(Quad, dy rrota aktive)
Klasi Q-2	(Quad, katër rrota aktive)
Klasi Q-3	(Quad, garuese femër)

5. Gjyqtaria

- 5.1 Gjyqtaria e garës përbëhet nga:
 - 1- Drejtuesi i eventit
 - 2- Drejtuesi i garës.
 - 3- Komisari teknik.
 - 4- Juria sportive e kohëmatjes, numërimit dhe vendimmarrjes.
 - 5- Mjeku i garës
- 5.2 Vendimet e jurisë dhe rezultatet do të publikohen në një zonë rreth 20 m pranë vendndodhjes së saj dhe në website të federatës

6. Penalizimet

- 6.1 Për çdo garë ka disa lloje penalltish.
- 6.2 Penalizime sportive
Penalizime disiplinire
- 6.3 Penalizimet shpjegohen në rregulloren specifike të çdo gare.

7. Numrat e garës

- 7.1 Numri i garës jepet ne fillim të çdo gare.
- 7.2 Çdo garues do pajiset me tre numra ngjithës.

8. Regjistrimet

- 8.1 Regjistrimi për çdo garë është i veçantë.
- 8.2 Afati i fundit për regjistrim është 48 orë përpara fillimit të garës.
- 8.3 Numri maksimal i pilotëve në garë do përcaktohet para garës.
- 8.4 Në oraret e kontrollit administrativ, të gjithë pilotët duhet të paraqiten dhe të sjellin dokumentet e kërkuara specifikisht.
- 8.5 Mosparaqitja në këto orare përbën skualifikim nga gara.
- 8.6 Kontrolli teknik i mjeteve do të bëhet në orarin e caktuar dhe brenda zonës së parkimit.
- 8.7 Pas kontrollit teknik, mjetet nuk mund të dalin më nga parkimi i caktuar.

9. Formati i garës

- 9.1 Gara zhvillohet në një ditë.
- 9.2 Gara është e tipit Cross Country Rally.
- 9.3 Navigimi në garë bëhet vetëm me Roadbook.
- 9.4 Gara ndahet në Seksione Lidhës dhe Seksione Specialë
Koha e seksionit special është edhe koha e garës. Plus penallti të mundshme.
- 9.5 Secila garë është e pavaruar dhe ka pikavarazh më vete për kampionatin.
- 9.6 Radha e nisjes në garën e parë të kampionatit do te bëhet me short.
Për garat e tjera do të bëhet sipas renditjes në kampionat.
(Specifikisht do tregohet para çdo gare)
- 9.8 Që garuesi të mund të marrë pikë, duhet të startojë dhe të kryejë minimumi Seksionin e parë lidhes.

10. Penalizimet

- 10.1 Penalizimet sportive jepen për mbërritje ose nisje të vonuar
Këto specifikohen përpara çdo gare.
- 10.2 Penalizimet Speed Limit jepen për tejkalim të shpejtësisë në zonat e limituara.
Këto specifikohen në tabelën e shpejtësive.
- 10.3 Penalizimet disiplinore jepen nga Komisioni i Disiplinës.

11. Pikët

- 11.1 Shkallëzimi i pikëve për çdo garë në renditje absolute:
30 pikë - Vendi i parë
24 pikë - Vendi i dytë
20 pikë - Vendet i tretë
dhe ne vazhdim....**18/16/14/12/10/8/6/4/2/1/1/1/.....**
- 11.2 Sistemi i pikavarazhit për çdo Klasë do të llogaritet më vete me të njëjtin sistem.
Në llogaritjes e pikavarazhit të klasave sistemi i pikëve do të pjestohet me 2.
- 11.3 Për të marrë pikë një pilot duhet të shkojë të shfaqet të në CP1.

12. Protestat

- 12.1 Çdo pilot që ka një protestë, duhet ta depozitojë atë me shkrim menjëherë pranë jurisë.
- 12.2 Brenda 30 minutash nga depozitimi i kërkesës Juria do të japë përgjigjen.
- 12.3 Limiti kohor i ankesave është jo më vonë se 30 minuta pas publikimit të rezultatit final.

13. Ceremonia e çmimeve

- 13.1 "60" minuta pas shpalljes së rezultatit, zhvillohet ceremonia e ndarjes së çmimeve.
Vendi i parë, i dytë dhe i tretë absolut - marrin kupë.
Vendi i parë, i dytë dhe i tretë për çdo klasë - marrin kupë.
- 13.2 Në podium pilotët fitues duhet të jenë me veshjet e garës.

14. Rregullore specifike

- 14.1 Përpara çdo garë mund të ketë një seri rregullash specifike për Raundin përkatës.
- 14.2 Këto rregulla do të mbivendosen mbi rregulloren e përgjithshme.

.....

Federata Shqiptare e Motoçiklizmit
SuperMoto 2026